

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORTI MBI MISIONIN

**Sistemi i Teknologjisë Informative dhe Diseminimi
Përmirësimi i Diseminimit përmes Internetit dhe Strategjia për
prezantimin e Informatave Gjeografike**

Komponenti nr 4.3.2 +4.5.3

Misioni i udhëhequr nga
Jesper Ellemose Jensen, Annegrete Wulff dhe Troels Aksel Vestergaard, Statistikat e Danimarkës

19-21 Janar 2015

IPA 2012

Emri i autorëve, adresa, e-maili

*Annegrete Wulff
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173155
Email: awu@dst.dk*

*Jesper Ellemose Jensen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173244:
Email: jej@dst.dk*

*Troels Aksel Vestergaard
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173933:
Email: tav@dst.dk*

Përmbledhje

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme.....	5
2. Vlerësimi dhe rezultatet.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	7
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 2. Personat e takuar	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.

Lista e Shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
TeR	Termat e Referencës
GIS	Sistemi i Informatave Gjeografike

Përmbledhje ekzekutive

Nëse raporti-teksti kryesor-tejkalon 4 faqe

*Përfshirë informatat për Udhëheqësin e Projektit dhe RTA.
Konkluzionet kryesore dhe shënimet prej rezultateve.*

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat. Është aktiviteti i tretë në këtë projekt që i kushtohet databazës PX-Web dhe i pari për komponentin 4.3.2a mbi GIS. Qëllimi i misionit ka qenë definimi i planit strategjik për GIS, si bazë për implementimin e mëtejme të projektit në këtë fushë.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

Aktiviteti 4.5.3:

- Sigurimi i cilësisë, instalimi dhe finalizimi i instalimit të PX-Web-it për publikim.
- Plani i punës i azhurnuar në lidhje me detyrat dhe ndarjen e tyre midis TI-së, diseminimit dhe fushave përkatëse statistikore.

Aktiviteti 4.3.a:

- Rishikimi i detajuar i përdorimit aktual dhe i ardhshëm i sofverit GIS për diseminim në ASK.
- Krijimi i hartës rrugore dhe dakordimi për strategjinë për përdorimin e GIS në vitet e ardhshme.

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Aktiviteti 4.5.3 do të sigurojë rezultatet e mëposhtme: Publikimin dhe sigurimin e cilësisë për databazën e diseminimit. ASK e ka të qartë rrjedhën e punës, sa i përket procedurave të azhurnimit dhe ndarjes së punës për të mirëmbajtur databazën, në mënyrë që të jetë e azhurnuar në baza të rregullta.

Vlerësimi dhe rezultatet – databaza

ASK ka prezantuar punën e bërë deri tani për vendosjen e tabelave në databazë, nga të gjitha fushat. Kjo ka qenë shumë punë impresionuese !! Nuk është qëllimi / rekomandimi të përfshihen të gjitha tabelat dhe pastaj të bëhet publike databaza e plotë pasi nuk janë akoma të gjitha tabelat të sigurta në aspektin e cilësisë.

Sipas planit të kaluar dhe sipas kërkesës së përdoruesve është vendosur të prioritetizohen statistikat mujore mbi tregtinë e Jashtme dhe statistikave të Çmimeve.

Do të ishte e preferueshme të merren statistikave të tregtisë së jashtme direkt nga burimi. Megjithatë, të dhënat janë të redaktuara dhe pastruara në "Comext / EuroTrace" kështu që është e mundur të merren të dhënat në formatin Excel nga atje. Është testuar me të dhënat mbi importin në tregti në Excel dhe teknikisht kjo ka funksionuar.

Për ta bërë më të lehtë përdorimin, megjithatë, është vendosur/rekomanduar të bëhen disa ndryshime me qëllim të plotësimit të tabelës me metadata shtesë.

Kodet e mallrave duhet të ndërrohen, në mënyrë që kolona të përmbajë kodin si dhe tekstin. Kolona e kodeve të shteteve duhet gjithashtu të përmbajë shtetin në tekst.

Prezantimi i kohës

Periudha e kohës duhet të ndërrohet nga dy kolona (viti në një kolonë dhe muaji në një) në një kolonë që përmban edhe vitin dhe muajin: 2013M01, 2013M02 etj. Kjo do të mundësojë vendosjen e serive më të gjata kohore edhe në grafikë. Rekomandohet që ASK në të gjitha tabelat të përdorë të njëjtin metodë emërtimi për kohën (20013, 2014 për vitet, 2013M01, 2013M02, 2014M12, për muajt dhe 2014Q1, 2014Q4 për të dhënat tremujore).

Koha duhet të vendoset në mënyrë konsistente ose në fillim ose në fund në të gjitha PX-tabelat. Nëse vendoset në fillim, përdoruesit nuk kanë nevojë të shkojnë poshtë për të pasur qasje në të dhënat e fundit. Nëse vendoset në fund, azhurnimet nga dosjet excel janë më të lehta dhe përdoruesit do të kenë seritë kohore / dosjet excel me të dhënat në mënyrë kronologjike.

Përgatitja e PX-tabelave për prezantim në harta

Ka pasur diskutime në lidhje me atë se si të lidhen të dhënat në PX-Web, që të prezantohen në hartë. Një kërkesë është të shtohen kodet në një kolonë të veçantë në të gjitha tabelat që përmbajnë shpërndarjet e komunave. Titulli i kolonës duhet të ketë të njëjtin emër / emërtim si kolona e tekstit. Në këtë rast Komuna mbi të dy kolonat.

Kjo po ashtu vlen për vendet nëse p.sh. statistikave të tregtisë do të paraqiten në harta, atëherë vendet duhet të kenë një kolonë të ndarë me kodet në Excel dhe emërtimi mbi të dy kolonat duhet të jetë Vendi.

Regjistrimi i Bujqësisë

Në fund të vitit ASK planifikon të publikojë rezultatet e regjistrimit të bujqësisë. Siç e kemi kuptuar, ASK do të përdorë PX-Web për të publikuar rezultatet e këtij regjistrimi. Kjo është shumë e rekomandueshme. Ne rekomandojmë që të gjitha fushat të përfshihen në databazë para se të jetë i gatshëm regjistrimi i bujqësisë, në mënyrë që PX-Web të jetë komplet funksional në fund të vitit dhe të kompletohet kur ti shtohet regjistrimi i bujqësisë.

Prezantim i shkurtër/ marketingu

ASK duhet të përgatisë një mjet informimi të shkurtër mbi PX-Web dhe mënyrën e nxjerrjes së të dhënave dhe i njëjti t'u shpërndahet studentëve në universitetet dhe ministrive relevante. Si model mund të merret shembulli danez.

Adaptimi i pamjes

Ekspertët, që kanë ushëhequr aktivitetet 4.4.1 dhe 4.4.2 të projektit të binjakëzimit, bashkë me stafin e diseminimit dhe TI-së në ASK, kanë zhvilluar një udhëzues mbi dizajnin për publikimet elektronike dhe të printuara. Këta udhëzues duhet të inkorporohen në PX-Web para se të bëhen publike.

Shtoni logon e BE-së

Para se të aktivizohet sistemi, duhet të shtohet logoja e Binjakëzimit të BE-së në PX-Web në mënyrë që të informohen përdoruesit që kjo pjesë e sistemit të diseminimit është financuar nga programi i Binjakëzimit të BE-së.

Vlerësimi dhe Rezultatet – Sistemet e Informimit Gjeografik

Misioni ka nisur me prezantimet nga Statistikat e Danimarkës dhe Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK) mbi gjendjen aktuale sa i përket GIS-it. Pjesa tjetër e aktivitetit ka qenë kryesisht në formë seminari, duke shkëmbyer mendimet në lidhje me diseminimin e të dhënave hapësinore, duke përdorur

sistemin GIS, në mes Idriz Shala nga ASK-së dhe përfaqësuesit të vendeve anëtare. Prezantimet e dhëna nga ASK dhe DST janë të përfshira në Aneksin 3.

Pjesa e ASK-së është prezantuar nga Z. Idriz Shala, ekspert i GIS në ASK dhe Z. Burim Limolli Shef i Divizionit të TI-së. Z. Troels A. Vestergaard Shef i Sektorit, ka folur mbi përdorimin e GIS në Statistikat e Danimarkës.

Gjatë prezantimeve dhe seminarit, janë vërejtur disa dallime në burimet e të dhënave në mes dy vendeve, por edhe shumë ngjashmëri në punën me GIS në prodhimin/diseminimin e statistikave.

Gjatë prezantimit dhe seminarit, u konkludua që ASK ka kapacitete shumë të mira të GIS-it dhe aspekti teknik në sistemin GIS dhe paraqitja hapësinore e statistikave, të krijuara në sistemin GIS, janë të gatshme për publikim.

Në lidhje me të ardhmen, është e qartë që detyra kryesore është dizajnimi dhe krijimi i një platforme diseminimi për punën e GIS në ASK.

Pas takimit me Z. Burim Limolli, Shef i Divizionit të TI-së në ASK është e qartë që duhet bërë analiza të mëtejme në lidhje me ngarkesën e punës për gjenerimin e kësaj platforme, para se të vendoset për platformën.

Përparësitë në zhvillimin e një platforme të re:

1. Platforma që përputhet me të gjitha nevojat e përdoruesve dhe po ashtu të përfshihet mundësia e diseminimit duke përdorur klasifikimin NUTS. Mundësia e përdorimit të klasifikimit NUTS kërkon një platformë me performance më të lartë se ajo aktuale. Për të qenë në një hap me direktiven INSPIRE është esenciale që të ketë bashkëpunim në territorin evropian. Është vitale që këto statistika përtej-kufirit, sidomos ato mbi fushën e ambientit, të integrohen në punën e GIS-it në faza të më hershme. Kërkesa për shpejtësi të lartë të diseminimit hapësinor është urgjente.
2. Platforma duhet të sigurojë mundësinë e ndërrimit në mes niveleve të ndryshme gjeografike. Në këtë mënyrë platforma mund të përdoret si bazë për vendimarrje në nivel lokal dhe kombëtar. Për tu siguruar që statistikat nga ASK janë në dispozicion për autoritetet e tjera lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Një platformë e re është e nevojshme për të krijuar një ambient GIS brenda ASK-së

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Rekomandimet në lidhje me PX-Web

Databaza e ASK-së do të zhvillohet gradualisht për të përfshirë të gjitha statistikat zyrtare në ASK. Në kohën e lançimit do të/duhet të përmbajë (së paku)

- Statistikat e jashtme të detajuara në baza mujore
- Statistikat e jashtme të agreguara – seria kohore më e gjatë
- Statistikat e çmimeve në baza mujore
- Statistikat e popullsisë sipas komunave

Se cilat variabla të përfshihen duhet të vendoset me stafin përgjegjës për fushat përkatëse dhe duhet të jenë variablat/informatat më të kërkuara nga përdoruesit.

- Rekomandohet të vendoset mbi datën e lançimit në fund të Shkurtit të vitit 2015 dhe të shpallet kjo datë në webfaqe.
- Rekomandohet të bëhet dhe dakordohet një plan për përfshirjen e tabelave të fushave të tjera
- Rekomandohet të bëhet një plan trajnimi – ose i mbështetur nga projekti i binjakëzimit.
- Do të jetë e nevojshme që më shumë persona të jenë në gjendje të krijojnë tabela në Excel dhe është e domosdoshme që më shumë të jenë në gjendje të azhurnojnë tabelat.
- Kur publikimi i të dhënave të kalojë nga forma e printuar/pdf në publikim online në databazë, ndoshta do të ishte kohë e përshtatshme për rishikimin e kalendarit të publikimeve.
- PX-Web duhet të mbulojë të gjitha fushat kur të përfundojë regjistrimi i bujqësisë.
- ASK duhet të zhvillojë një broshurë të shkurtër mbi databazën pasi të jetë kompletuar.
- Duhet të përgatitet ndonjë material informues dhe/ose trajtim mbi sistemin për stafin në ministritë relevante dhe studentëve
- Përshtatja e PX-Web sipas udhëzuesve mbi dizajnin të zhvilluar nga TI-ja, Diseminimi dhe projekti i Binjakëzimit
- Shtimi i logos së Binjakëzimit të BE-së në sistem para se të lançohet në publik

Rekomandimet në lidhje me GIS

Rekomandimet e përgjithshme:

- Vazhdimi i zhvillimit të standardit të lartë të publikimeve të printuara GIS
- Pjesëmarrja në forumin ndërkombëtar, Forumi Evropian për Gjeografi dhe Statistika (EFGS)

Rekomandohet që, në lidhje me planformën e diseminimit, ASK të fokusohet në përdorimin më të lehtë dhe performacën e TI-së

- Të sigurohet që platformë, që është e lehtë për ta përdorur
- Ti mundësohet ASK-së të arrijë standardin e klasifikimit NUTS – Informatat përtej kufirit
- Të dizajnohet si bazë për diseminimin e punës së GIS-it në ASK
- Burim i dobishëm informativ për qeverinë lokale
- Takim informues / takim me përdoruesit / autoritetet lokale

Rekomandohet që ASK të marrë përvojat në zhvillimin e platformës së diseminimit edhe nga Agjencioni i Statistikave të Shqipërisë

Rekomandohet që platform e diseminimit të GIS të ketë një link në faqen zyrtare të ASK-së Fokusi kryesor do të jetë ndërtimi i platformës së diseminimit.

Veprimi	Afati	Përgjegjësi
1. Krijimi i platformës për diseminimin e statistikave të ASK-së duke përdorur sistemin GIS	1-2. T 2015	ASK
2. Përbajtja e platformës së diseminimit GIS	1-2. T 2015	ASK
3. Ngarkimi i të dhënave në platformë	2-3. T 2015	ASK

4. Publikimi i platformës së re të diseminimit (Atlas)	3-4. T 2015	ASK
5.Kërkimi i mendimeve edhe nga përdoruesit për zhvillimin e mëtejshëm të platformës	Pas publikimit të gjeneratës së parë të të dhënave në databazë	ASK

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së KS12 IB ST 01 Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 4: Sistemi i Teknologjisë Informative dhe Diseminimi
Aktiviteti 4.3.2a&4.5.3: Misioni i kombinuar: 1. Strategjitë për prezantimin e informatave gjeografike dhe 2. Zhvillimi i Diseminimit të të Dhënave III – Organizimi i rrjedhës së punës dhe azhurnimi i procedurave

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 19 Dhjetor
Fillimi / fundi i aktivitetit: 19 – 22 Janar 2015
Koha e raportimit: 30 Janar 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
Rezultati obligativ 4.2, 4.3, dhe 4.5.3	Zhvillimi i sistemit të TI-së dhe diseminimit përmes web-it Zhvillimi i Databazës së Diseminimit	<ul style="list-style-type: none"> Web faqja e ASK dhe përmirësimi i përdorimit të saj, deri në tremujorin e 8-të i projektit Databaza e diseminimit, e instaluar dhe në dispozicion deri në tremujorin e 7-të të projektit. Raporti i misionit, i vendosur në webfaqen e projektit Diskutimi i rekomandimeve për punën në të ardhmen dhe azhurnimi i planit të punës Përshkrimi i rrjedhës së punës / Puna ndahet midis stafit të TI, diseminimit dhe statisticientëve përkatës 	<ul style="list-style-type: none"> Web faqja e ASK Databaza e Diseminimit Raportet Tremujore të Binjakëzimit Raportet e Misionit 	<ul style="list-style-type: none"> Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit Funksionimi i teknologjisë së TI Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 4.3.2a

Përshkrimi i gjendjes aktuale në lidhje me përdorimin e softverit GIS për të përmirësuar diseminimin nëpërmjet wefaqes.

Rezultate e pritura nga aktiviteti 4.3.2a aktiviteti

Aktiviteti 4.3.2a do të sigurojë këto rezultate:

Raporti i misionit me vështrim mbi përdorimin aktual dhe të ardhshëm të softverit GIS për diseminim në ASK dhe rekomandimet për punën në të ardhmen.

ASK-ja do të njoftojë ekspertët e vendeve anëtare në lidhje me platformën teknike aktuale, që përdoret për GIS, dhe problemet që mund të lidhen me të.

Ekspertët e vendeve anëtare do të njoftojnë stafin në lidhje me strategjinë e vendeve anëtare për GIS dhe planet e Eurostatit për këtë çështje.

ASK-ja dhe përfaqësuesit e vendeve anëtare do të përpilojnë hartën rrugore duke rënë dakord për strategjinë për përdorimin e GIS në vitet e ardhshme

ASK do të njoftojë ekspertët e vendeve anëtare në lidhje me mundësinë e përgatitjes së GIS/'Shape files' që mund të integrohen.

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 4.5.3

Sigurimi i cilësisë, mundësimi i instalimit dhe finalizimi i instalimit të PX-Web për publikim.

Plani i punës i azhurnuar në lidhje me detyrat dhe ndarjen e tyre midis TI-së, diseminimi dhe fushave statistikore përkatëse.

Diskutimi mbi lançimin e databazës.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 4.5.3

Aktiviteti 4.5.3 do të sigurojë rezultatet në vijim:

Publikimin dhe sigurimin e cilësisë për databazën e diseminimit. ASK e ka shumë të qartë rrjedhën dhe ndarjen e punës për mirëmbajtjen e databazës, që të azhurnohet në baza të rregullta.

Stafi i ASK-së:

1. Z. Burim Limolli, Shef i TI-së - Divizioni, burim.limolli@rks-gov.net ASK
2. Z. Idriz Shala, Ekspert i GIS, idriz.shala@rks-gov.net, ASK
3. Znj. Drita Sylejmani, Zyrtare e Diseminimit, Drita.sylejmani@rks-gov.net, ASK
4. Znj. Shqipe Gashi, Zyrtare e Diseminimit, Shqipe.gashi@rks-gov.net, KAS
5. Znj. Kumrije Beqiri, Zyrtare e Diseminimit, kumrije.beqiri@rks-gov.net, KAS

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Ms Annegrete Wulff, Shef i Divizionit, Statistikat e Danimarkës, awu@dst.dk

Mr Jesper Ellemose Jensen, Këshilltari Kryesor, Statistikat e Danimarkës, jej@dst.dk

Mr Troels Vestergaard, Shef i Sektorit, Statistikat e Danimarkës, tav@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dkZnj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com**Historiku**

Raporti AGA i vitit 2012 deklaroi që është shumë e nevojshme të përmirësohet web faqja e ASK-së, për ta bërë më të lehtë për përdoruesit dhe një mjet më fleksibil të diseminimit.

Komponenti 4 në kuadër të Projektit të Binjakëzimit ka tri rezultate obligative për të përmbushur këto nevoja:

Specifikacioni i tenderit për rrjetin e brendshëm (nga projekti SIDA)

Përmirësimi i web faqes së ASK-së dhe përdorimi më i lehtë i saj

Instalimi dhe përdorimi i Databazës së Diseminimit

Në përgjithësi aktivitetet në kuadër të komponentit 4 do të adresojnë këto çështje:

- Përmirësimi i diseminimit përmes web faqes i statistikave të caktuara, duke përfshirë përmirësimin e web faqes së ASK-së dhe duke e bërë atë më të lehtë për ta përdorur dhe mjet më fleksibil diseminimi;
- Zhvillimi i udhëzuesve për dizajnimin e tabelave dhe grafikëve, që po ashtu të përdoren për diseminim përmes web faqes;
- Zhvillimi i databazës së diseminimit, përfshirë metadata më të kompletuara që mbulojnë aspekte të ndryshme, që lidhen me cilësinë e të dhënave;
- Zhvillimi i strategjisë dhe rekomandimeve për statistikave, të vizualizuara gjeografikisht
- Plani i punës i azhurnuar për implementimin e databazës së diseminimit.
- Përshkrimi i rrjedhës së punës dhe ndarja e punëve midis TI-së, diseminimit statisticientëve të fushave përkatëse

Aktivitetet që duhet të ndërmerren si parapërgatitje për misionin:

Përgatitja /dakordimi për listën e fushave që do të përdoret në databankë

Përgatitja e tabelave dhe vendimet sipas rekomandimeve në raportin 4.5.1 dhe 4.5.2:

<http://ask.rks-gov.net/statbank>

<http://databank.ask.rks-gov.net/>

ose modalitete të ndryshme.

Lista e dokumentave të bashkangjitura

- Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global (AGA)
- Programi i statistikave zyrtare 2013 -2017
- Plani Zhvillimor Strategjik 2009- 2013
- Përkrahja Suedeze për Zhvillimin e Statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës
- ICT në Sistemin e Statistikave Kombëtare në Kosovë – Rishikimi bazë dhe Rekomandimet për zhvillim (Dekker)

Aneksi 1. Programi - Janar 2015

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09:30	Hyrje në këtë pjesë të komponentit 4
		09:45	ASK do të prezantojë para ekspertëve gjendjen aktuale të përdorimit të GIS në ASK
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	ASK do të prezantojë lidhur me Gjeoportalin Kombëtar
		11:30	Dreka
		13:00	Vendet anëtare, GIS në Statistikat e Danimarkës- organizimi i punës dhe burimet e të dhënave.
		14:30	Pushim për kafe
		15:00 – 16:00	Zhvillimi i Databazës së Diseminimit
2	ASK	09:00- 16:00	Zhvillimi i vazhdueshëm i Databazës së Diseminimit Zhvillimi i shkëmbimit të njohurive në fushën e GIS-it
3	ASK	09:00- 12:00	Dakordimi mbi rekomandimet, koha e planifikuar dhe programi i punës për GIS dhe databazën e diseminimit, që duhet të realizohet nga ASK-ja Shkrimi i Raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

Stafi i ASK-së:

1. Z.Burim Limolli, Shef i TI-së - Divizioni, burim.limolli@rks-gov.net ASK
2. Z.Idriz Shala, Ekspert i GIS, idriz.shala@rks-gov.net, ASK
1. Znj.Drita Sylejmani, Zyrtare e Diseminimit, Drita.sylejmani@rks-gov.net, ASK
2. Znj. Shqipe Gashi, Zyrtare e Diseminimit, Shqipe.gashi@rks-gov.net, ASK
3. Znj. Kumrije Beqiri, Zyrtare e Diseminimit, kumrije.beqiri@rks-gov.net, ASK

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Përkthyesi (në disa misione)